

**AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"DOEMOS TECH" SH.P.K**

Sot, me date 20/01/2025(dymije e njezetepese), i pranishem:

- z.**Ferit Tarushi**, shtetas shqiptar, lindur me 18.02.1997 ne Rajce e banues ne Tirane, mbajtes i Leternjoftimit ID me Nr. 033226065 dhe me numer personal J70218044L, madhor e me zotesi te plote juridike per te vepruar;

ne cilesine e ortakut te vetem themelues shpall hartimin dhe nenshkrimin e ketij Akt themelimi ne perputhje me legjislacionin shqiptar mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në Fuqi të Republikës së Shqipërisë, në ligjin Nr.7512 Datë 10.08.1991" Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, nismës së lirë dhe të veprimtarisë private dhe privatizimit", te ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për shoqëritë tregtare" dhe të ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Q.K.B dhe formalitetet që duhet respektuar nga Shoqëritë Tregtare , me vullnetin e tij të lirë , të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt- themelimi dhe me termat si me poshte vijon.

**Neni 1  
Emertimi**

Formohet shoqëria tregtare me përgjegjisi të kufizuara e emertuar "**Doemos Tech**" SH.P.K. Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit Shqipëtar, ndërsa deget që mund te krijohen do ti nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërise që do të miratohet nga ortaku i vetëm themelues.

**Neni 2  
Selia**

Selia e shoqërise tregtare me përgjegjisi të kufizuara "**Doemos Tech**" SH.P.K do të ketë selinë në Rr."Kavajes ndërtesa nr 116, ish qendra Gurten Tiranë .Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj , të hape zyra përfaqesie , dege , të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërise, vetëm me vendim te asamblesë.



### **Neni 3**

#### **Kohëzgjatja e veprimtarisë**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është e pakufizuar. Afati fillon nga momenti i regjistrimit të shoqërisë në Regjistrin Tregtar të Qëndres Kombëtare të Biznesit (QKB).

### **NENI 4**

#### **Objekti i veprimtarisë**

Shoqëria “**Doemos Tech**” sh.p.k. do të zhvillojë aktivitetin e saj në fushën e teknologjisë dhe inovacionit, duke përfshirë:

1. **Zhvillimin dhe hartimin e programeve teknologjike**, të tilla si:
  - Faqe interneti (website) të personalizuar dhe funksionale.
  - Aplikacione mobile (mobile applications) për platforma të ndryshme, si iOS dhe Android.
  - Projekte teknologjike të tjera, përfshirë zhvillimin e softuerëve të avancuar dhe sistemeve të menaxhimit të të dhënave.
2. **Ofrimin e shërbimeve të mirëmbajtjes dhe mbështetjes teknologjike**, duke përfshirë:
  - Përditësime dhe optimizime për sistemet e zhvilluara.
  - Trajtimin e problemeve teknike dhe mbështetje të vazhdueshme për klientët.
3. **Konsulencë teknologjike dhe trajnim profesional**, me fokus në:
  - Analizën e nevojave teknologjike të bizneseve dhe individëve.
  - Zhvillimin e strategjive teknologjike për përmirësimin e efikasitetit dhe produktivitetit.
  - Organizimin e trajnimeve për përdorimin efektiv të zgjidhjeve teknologjike të implementuara.
4. **Zhvillimi i inovacioneve digjitale dhe projekteve kreative**, duke u përshtatur me kërkesat e tregut dhe teknologjitë e reja, për të siguruar zgjidhje të personalizuar dhe të qëndrueshme.
5. **Aktivitete të tjera plotësuese**, të cilat janë në përputhje me misionin dhe vizionin e shoqërisë për avancimin teknologjik, në përputhje me legjislacionin në fuqi.



## **NENI 5**

### **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar I shoqërisë është 100.000 ALL (njëqind mijë lekë) dhe është I përbërë nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale 100.000 ALL (njëqind mijë lekë).

Kapitali themeltar zotërohet totalisht nga ortakët I vetëm z.**Ferit Tarushi**, shtetas shqiptar lindur më 18.02.1997 në Rajcë e banues në Tiranë, mbajtës i Leternjoftimit ID me Nr. 033226065 dhe me numër personal J70218044L.

## **NENI 6**

### **Organet e shoqërisë**

Organet e shoqërisë janë Asambleja e përgjithshme dhe organi administrativ. Asambleja e përgjithshme e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë dhe vepron në përputhje me statutin e shoqërisë dhe ligjet në fuqi.

Organi i vetëm Administrativ i shoqërisë është Administratori i saj i vetëm:

- z.Ferit Tarushi shtetas shqiptar lindur më 18.02.1997 në Rajcë e banues në Tiranë, mbajtës i Leternjoftimit ID me Nr. 033226065 dhe me numër personal J70218044L, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

që do të qëndrojë në detyrë për një periudhë 5 vjetecare me të drejtë rizgjedhje.

Administratori ka të gjitha kompetencat për administrimin e zakonshëm të shoqërisë, në përputhje me sa parashikohet nga ligji, nga akti i themelimit dhe nga statusi i shoqërisë.

Administratori ka të drejta dhe kompetenca të plota për kryerjen e të gjithave veprimeve që do të konsiderojë të dobishme për realizimin e objektivave të shoqërisë, me përjashtim të atyre që kërkojnë miratimin paraprak të Asamblesë të përgjithshme.

Administratori përfaqëson shoqërinë në marrëdhënie me të tretet, përpara organeve shtetërore dhe private.

## **NENI 7**

### **Të ardhurat**

Të ardhurat neto të shoqërisë i takojnë ortakëve në përpjesëtim me kuotat që zotërojnë.



## **NENI 8**

### **Kontrolli financiar**

Asambleja e Ortakeve/Ortaku i vetëm mund të emërojë një apo disa ekspertë kontabël të cilët kanë detyrën të kryejnë kontrollin kontabël dhe financiar të shoqërisë gjithashtu ka të drejtë të emërojë likuidator për problemet e shoqërisë si dhe të pajtojë persona të tjerë si ortakë.

## **NENI 9**

### **Legjislacioni i aplikueshëm**

Veprimtaria e shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë

## **NENI 10**

### **Zgjidhja e mosmarrveshjeve**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet ortakëve ose ndërmjet ortakëve dhe shoqërisë që ka lidhje me të drejta të disponueshme në lidhje me marrëdhëniet e tyre me shoqërinë do të drejtohen për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## **NENI 11**

### **Dispozita finale**

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe vecanërisht të Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Krijimin e Shoqerive Tregtare" , si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri .

Akti i themelimit u përpilua në 3( tre) kopje, për t'ju shpërndarë organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë "**Doemos Tech**" SH.P.K

Akti i themelimit u lexua edhe u nënshkrua nga ortaku i shoqërisë pa asnjë rezervë atë.

### **Ortaku themelues**

Ferit Tereshi

